REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

"NEGENET" SH.P.K.
Nr. i biznesit 70845652
Pronar –Ylli ZEKA
OK Negenet Sh.p.k.
Rr/Ahmet Kaqiku p.n.
Ferizaj

"IPTV TECH" L.L.C.
Nr. i biznesit 71251268
Pronar: Fidan GOGA
Rr/Rexhep Taku nr. 5
Pejë

Ref: 1605/395/LIC/ni

# VENDIM

për ndryshimin e pronësisë së operatori kabllorë Negenet Sh.p.k. dhe bartjen e saj nga "NEGENET" SH.P.K. në "IPTV TECH" L.L.C.

---

## Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Medive (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.

2. Negenet Sh.pk. është operatorë kabllorë, i cili është i licencuar për distribuimin e kanaleve radio televizive përmes rrjetit kabllorë. Negenet Sh.p.k., është pajisur me licencë të KPM-së për operatorë kabllorë, me datën 30 tetor 2013.

3. Më datën 18 prill 2015, pronari i Negenet Sh.p.k. z. Ylli ZEKA, ka parashtruar një kërkesë për ndryshimin e pronësisë dhe bartjen e sajë nga "NEGENET" SH.P.K në "IPTV TECH" L.L.C., me pronar z. Fidan GOGA.

## Arsyetimi

4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja*".

5. Neni 21, paragrafi 3 i Ligjit të KPM-së përcakton se: "*licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim të KPM-së*".



Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Prištin- Pristina/Kosovë-Kosovo Tel: (+381) (0) 38 245 031 Fax: (+381) (0) 38 245 034 E-mail: info@kpm-ks.org; ëëë kpm-ks.org;

6. Neni 15. pika 2. Paragrafi 1 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*Për çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që kanë ndikim të theksuar në kontrollin e të Licencuarit, kërkohet paraprakisht aprovimi me shkrim nga ana e KPM-së*"

7. Neni 15.4 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: "*KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur sigurohet që personi fizik apo juridik, për të cilin propozohet që t'i transferohet licenca, i plotëson standardet e KPM-së për t'iu dhënë një licencë.*"

8. Komisioni konstaton se kandidati ka kryer të gjitha obligimet lidhur me tarifën vjetore të licencës së KPM-së.

9. Komisioni konsideron se kërkesa e parashtruar për ndryshimin e pronësis së operatorit kabllorë është e kompletuar në pajtim me Rregullorën për Dhënjën e Licencës së KPM-së (KPM-213/04) si dhe Regulloren CIMC-2007/04 për operatorët kabllorë dhe si e tillë, i përmbushë kushtet për miratim.

**VENDIM**

10. Komisioni në takimin e mbajtur me datën 2 qershor 2016, merr vendim për ndryshimin e pronësisë së operatorit kabllorë Negenet Sh.p.k. dhe bartjen e licencës nga personi juridik "NEGENET" SH.P.K., në personin juridik "IPTV TECH" L.L.C. si dhe licenca të ndryshohet.

**Lëshimi i Vendimit**

11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

2 qershor 2016
datë



Komisioni i Pavarur i Mediave/Nezavisna Komisija za Medije/Independent Media Commission, Rr.Ul.Str. Perandori Justinian Nr. 14 Qyteza, Pejton, 10000 Prishtinë-Priština-Pristina/Kosovë-Kosovo. Tel: (+381) (0) 38 245 031. Fax: (+381) (0) 38 245 034. E-mail: info@kpm-ks.org; ëëë.kpm-ks.org;

395.

Lloji i dërgesës
Vrsta pošiljke ______

Vlera e cekur - Shuma e dërguar ______
Označona vrednost - poslani iznos

nën numër ______
pod br.

për NEGENET" SH.P.K / YILI ZEICA
za KK/ AHMET KAQICU P.N / FERIZAJ

(Vendi)
(Mesto)

Poshtë i nënshkruari deklaron që dërgesa e cekur (shuma e dërguar) është dorëzuar në rregull (paguar me datë) 27.06.16
Dole potpisani izjavljuje da je pomenuta pošiljka (poslani iznos) predata uredno (placena dana)

Nënshkrimi i marrësit
Potpis primaoca

Vula e postës së vendit
Pečat pošte

Nënshkrimi i nënpunësit të postës së vendit
Potpis radnika pošte